



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Drejtoria e Bujqësisë

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen të gjithë bletarët e komunës së Prishtinës se mund të aplikojnë për subvencione në lëmin e bletarisë - pagesa direkte:

Kriteret :

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës;
- Duhet të ketë sipërfaqe të tokës, së paku 0,20 ha, në territorin e komunës së Prishtinës;
- Përkrahen bletarët që kanë 10-30 shoqëri bletësh;
- Përfituesi duhet të jetë banorë, si edhe të ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarin bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e paluejtshme, me afat deri në një vit;
- Certifikata veterinare-shëndetësore e lëshuar nga Praktikat veterinare të licencuara nga AUV.

Data e aplikimit, prej 30.03. deri 12.04.2017.